



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/154
Datë: 09.08.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 9 gusht 2023, merr këtë:


V E N D I M

Për ndryshimin dhe plotësimin e Programit Legjislativ të vitit 2023

1. Ndryshohet dhe plotësohet Programi Legjislativ i Qeverisë së Republikës së Kosovës për vitin 2023, si në vijim:
 - 1.1. Shtohet në Programin Legjislativ për vitin 2023:
 - 1.1.1. Projektligji për Inspektoratin Qendror të Trashëgimisë Kulturore (MKRS), afati i miratimit në Qeveri 30.10.2023;
 - 1.1.2. Projektligji për Faturat e Kulturave Bujqësore dhe Fletë magazinat (MBPZHR), afati i miratimit në Qeveri 31.10.2023;
 - 1.1.3. Projektligji për Ratifikimin e Marrëveshjes Ndërkombëtare ndërmjet Kosovës nga njëra anë dhe Bashkimit Evropian nga ana tjetër, për pjesëmarrjen e Kosovës në Programin e Bashkimit, Programi i Tregut të Vetëm (MINT), afati i miratimit në Qeveri 15.09.2023;
 - 1.1.4. Projektligji për Mbrojtjen e Konsumatorit (MINT), afati i miratimit në Qeveri 25.12.2023.
2. Në Programin Legjislativ për vitin 2023 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, shtyhet afati i miratimit në Qeveri, i këtyre projektligjeve:
 - 2.1. Projektligji për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme (MMPHI), afati i miratimit 30.09.2023;
 - 2.2. Projektligji për Banimin Social (MMPHI), afati i miratimit 30.09.2023;
 - 2.3. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.2003/11 për Rrugët (MMPHI), afati i miratimit 30.09.2023;
 - 2.4. Projektligji për Statusin, Qëndrimin e Përkohshëm dhe Kalimin Tranzit të Forcave të Huaja të Armatosura në Territorin e Republikës së Kosovës (MM), afati i miratimit 30.11.2023;
 - 2.5. Projektligji për vlerësimin dhe shqyrtimin e akteve të komunave (MAPL), afati i miratimit 31.10.2023;
 - 2.6. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që Përmbajnë Procedura të Veçanta Administrative dhe Harmonizimin e Tyre me Ligjin Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, faza e dytë (MPB), afati i miratimit në Qeveri 29.09.2023;

- 2.7. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjeve që kanë të Bëjnë me Racionalizimin dhe Vendosjen e Vijave Llogaridhëse të Agjencive (MPB), afati i miratimit në Qeveri 29.09.2023;
 - 2.8. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-022 për Përdorimin Civil të Eksplozivëve (MPB), afati i miratimit në Qeveri 29.09.2023;
 - 2.9. Projektligji për të Huajt (MPB), afati i miratimit në Qeveri 29.09.2023;
 - 2.10. Projektligji për Gjendjen Civile (MPB), afati i miratimit në Qeveri 22.09.2023;
 - 2.11. Projektligji për Armë, (MPB) afati i miratimit në Qeveri 22.12.2023;
 - 2.12. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 05/L-015 për Letërnjoftim, (MPB), afati i miratimit në Qeveri 22.12.2023;
 - 2.13. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.04/L-049 për Zjarrëfikje dhe Shpëtim (MPB), afati i miratimit në Qeveri 13.12.2023.
3. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Vendimin t'ia dërgojë Kuvendit të Republikës së Kosovës.
 4. Obligohet Zyra Ligjore në Zyrën e Kryeministrit për zbatimin e këtij Vendimi.
 5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/154
Datë: 09.08.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 9 gusht 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji për Ratifikimin e Marrëveshjes në mes të Republikës së Kosovës, e përfaqësuar nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, dhe Deutsche Gesellschaft Für Zusammenarbeit (Giz) GmbH, për Projektin Mbështetja për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Sektorit të Bujqësisë në Zonat Rurale përmes Diversifikimit të Aktiviteteve.
2. Projektligji nga pika 1. e këtij Vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe miratim.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/154
Datë: 09.08.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 9 gusht 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Rregullorja për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive.
2. Obligohet Zyra e Kryeministrit, Ministrisë dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e Rregullores nga pika 1. e këtij Vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/154
Datë: 09.08.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 9 gusht 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Udhëzimi Administrativ për Masat e Duhura Parandaluese dhe Mbrojtëse për Ndalimin e Pjesëmarrjes së Fëmijëve në Klubet e Natës dhe hapësira të tjera të ngjashme.
2. Obligohet Ministria e Punëve të Brendshme dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e Udhëzimit Administrativ nga pika 1. e këtij Vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/154
Datë: 09.08.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 9 gusht 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Udhëzimi Administrativ për Ambalazhin dhe Mbeturinat e Ambalazhit.
2. Obligohet Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e Udhëzimit Administrativ nga pika 1. e këtij Vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/154
Datë: 09.08.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 9 gusht 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Plotësohet pika 2. e Vendimit të Qeverisë Nr. 10/109, të datës 23 nëntor 2022 ashtu që shfuqizohet akti nënligjor, si në vijim:
 - 1.1 Rregullore Nr. 04/2012 për Evidencën Zyrtare të Kërkesave për Qasje në Dokumente Publike.
2. Obligohet Zyra për Publikimin e Gazetës Zyrtare që të publikojë shfuqizimin e aktit nënligjor sipas pikës 1. të këtij Vendimi në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

A r s y e t i m

Sundimi i ligjit është një nga vlerat themelore të rendit kushtetues të Republikës së Kosovës. Në këtë kontekst, parimi i ligjshmërisë së akteve nënligjore në kuptimin e ndalimit të veprimit arbitrar të të gjitha organeve të cilat mund të intervenojnë në marrëdhëniet ndërmjet subjekteve të së drejtës vetëm në bazë të autorizimeve të fituara me ligj, derivon edhe nga Seksioni II, A, 1, 2,4, i Listës së Kontrollit të Sundimit të Ligjit, të nxjerrë nga Komisioni i Venedikut, ku në mënyrë shprehimore përcaktohet obligimi i institucioneve për të vepruar në pajtueshmëri strikte me kompetencat e përcaktuara me ligj.

Me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr.06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike, me nenin 31 paragrafi 6 të tij, është autorizuar Komisionerja e Agjencisë për Informim dhe Privatësi që të nxjerrë aktin nënligjorë për rregullimin e kësaj fushe, me çka është e nevojshme shfuqizimi i Rregullores (QRK) Nr. 04/2012 për Evidencën Zyrtare të Kërkesave për Qasje në Dokumente Publike, e cila bazohet në Ligjin e mëparshëm për Qasjen në Dokumentet Publike, tani të shfuqizuar.

Andaj, shfuqizimi i këtij akti nënligjorë, krahas edhe shfuqizimit të akteve të tjera nënligjore me Vendimin e Qeverisë Nr. 09/110, të datës 23 nëntor 2022, është në funksion të plotë të sigurimit të sundimit të ligjit, përmes sigurimit të parimit të ligjshmërisë përkatësisht sipas Seksionit II, A, 1, 2, 4, 7 të Listës së Kontrollit të Sundimit të Ligjit dhe parimit të sigurisë juridike sipas Seksionit II, B, 1, 3, 4, 5 të së njëjtës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 07/154
Datë: 09.08.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 11 paragrafi 8. të Ligjit Nr.08/L-066 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 9 gusht 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e Këshillit Kombëtar Shqiptar, për ndarjen e mjeteve buxhetore në shumë prej 254,562.30 € (dyqindtë e pesëdhjetë e katër mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë euro e tridhjetë centë), për pajisje me tekste mësimore në gjuhën shqipe për nxënësit Shqiptarë që vijojnë mësimin në gjuhën shqipe në shkollat fillore, në komunat Preshevë, Medvegjë e Bujanoc, për vitin shkollor 2023-2024.
2. Për zbatimin e këtij Vendimi do të përdoren mjetet nga organizata buxhetore Zyra e Kryeministrit me kod 104, nën-programi "Përkrahje për Luginën e Preshevës" me kod 39100, kategoria e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere".
3. Mjetet nga pika 1. e këtij Vendimi do të transferohen në llogarinë bankare në emër të Këshillit Kombëtar Shqiptar.
4. Obligohet Zyra e Kryeministrit për zbatimin e këtij Vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 08/154
Datë: 09.08.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 29 të Ligjit Nr. 05/L-049 për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 08/L-034, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, nenin 6 (paragrafi 4 nën-paragrafi 4.2) të Udhëzimit Administrativ MD. Nr. 13/2022 për Mënyrën dhe Procedurat e Shitjes dhe Dhënies me Qira të Pasurisë së Luajtshme dhe të Paluajtshme të Sekuestruar dhe të Konfiskuar, dhe në përputhje me Vendimin e Qeverisë Nr. 22/84, të datës 22 qershor 2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 9 gusht 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet propozimi i Ministrisë së Drejtësisë për dhënie e pronës së paluajtshme në shfrytëzim Komunes së Prishtinës për përfituesit e skemës sociale, përkatësisht banesën në Lagjen "Ulpiana", ob. E-30 L, kati përdhësë, Nr. 4, Prishtinë, e konfiskuar me Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, PKR. Nr. 642/15, të datës 28 qershor 2017.
2. Obligohet Ministria e Drejtësisë për zbatimin e këtij Vendimi.
3. Komuna e Prishtinës merr përsipër dhe është përgjegjëse për të gjitha obligimet dhe detyrimet e banesës nga momenti i marrjes në shfrytëzim.
4. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes së tij në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 09/154
Datë: 09.08.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 4, paragrafi 2. të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 9 gusht 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet në parim Nisma për negocimin e Marrëveshjes së Grantit ndërmjet Republikës së Kosovës, e përfaqësuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim, për Projektin për Përmirësimin dhe Rehabilitimin e Sistemeve të Ujitjes.
2. Obligohet Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve për ndërmarrjen e hapave konform dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare dhe legjislacionit tjetër në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 10/154
Datë: 09.08.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 9 gusht 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Koncept-dokumenti për fushën e Mbikëqyrjes së Tregut të Produkteve.
2. Obligohet Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij Vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 11/154
Datë: 09.08.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 9 gusht 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet Programi për Diplomaci Qytetare 2023-2025, i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës.
2. Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është Programi për Diplomaci Qytetare 2023-2025, i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës.
3. Për zbatimin e këtij Programi, Qeveria ndan mjete buxhetore sipas Ligjit të Buxhetit për vitin përkatës.
4. Për zbatimin e këtij Programi për vitin 2023-2024 ndahen mjetet buxhetore në vlerë 325,000.00 € (treqind e njëzet e pesë mijë euro) si në vijim: 250,000.00 € (dyqind e pesëdhjetë mijë euro) për kategorinë ekonomike "Subvencione dhe transfere" dhe 75,000.00 € (shtatëdhjetë e pesë mijë euro) për kategorinë ekonomike "Mallra dhe shërbime".
5. Mjetet, sipas pikës 4. të këtij Vendimi, ndahen nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, sipas rregullimeve të brendshme buxhetore.
6. Obligohen institucionet përgjegjëse për zbatimin e këtij Vendimi, në pajtim me legjislacionin në fuqi.
7. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

V E N D I M

**PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT 2023 – 2025 PËR DIPLOMACI QYTETARE
TË MINISTRISË SË PUNËVE TË JASHTME DHE DIASPORËS**

Neni 1

Qëllimi

Programi për Diplomaci Qytetare është një program i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës (MPJD), i filluar në vitin 2022. Ky program synon ta forcojë lidhjen e diasporës me institucionet e Republikës së Kosovës, duke i krijuar mundësi të përfshihet drejtpërdrejt në institucionet publike të Republikën së Kosovës përmes angazhimit profesional për një periudhë deri në dhjetë muaj (10).

Ky program është në harmoni me zotimet e Qeverisë për përfshirjen sa më të madhe të diasporës në politikëbërje, në transferim të dijes dhe të përvojës, si dhe bazohet në Programin e Qeverisë së Republikës së Kosovës 2021 – 2025, pika 2.17.5 - rritja e rolit të mërgatës në zhvillimin dhe në promovimin e vendit.

Për realizimin e këtij programi, MPJD-ja buxhetin e saj do ta shfrytëzojë për:

1. subvencionimin e së paku 25 profesionistëve nga diaspora për angazhim profesional për një periudhë deri në dhjetë muaj (10), në institucionet e Republikës së Kosovës;
2. subvencionimin në vlerë deri në €10,000 (dhjetë mijë euro) për secilin kandidat të suksesshëm që angazhohet në institucionet e Republikës së Kosovës;
3. financimin e një bilete kthyesë të aeroplanit për kandidatët e suksesshëm që do të angazhohen në kuadër të këtij programi;
4. organizimin i vizitave studimore dhe aktiviteteve informuese gjatë zbatimit të programit.

Neni 2

Fushëveprimi

Programin e zbaton:

1. Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, përkatësisht Departamenti për Diplomaci Publike.
2. Buxheti i ndarë për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, për subvencionimin e personave fizikë, realizohet në bazë të këtij programi dhe sipas dispozitave të këtij vendimi.
3. Buxheti i ndarë për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës sipas kategorive të përcaktuara, për vitin 2023, bëhet nga ndarjet e brendshme buxhetore, ndërsa për zbatimin e këtij programi për vitin 2024 dhe 2025 Qeveria ndan mjete buxhetore sipas ligjit mbi ndarjet buxhetore për vitin përkatës.

Neni 3

Bashkëpunimi dhe koordinimi

1. Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, gjatë gjithë procesit të zbatimit të Programit për diplomaci qytetare, do të bashkëpunojë dhe do të koordinohet ngushtë me Zyrën për Qeverisje të Mirë në Kryeministri, me qëllim të rritjes së transparencës dhe llogaridhënies për standardet dhe procedurat për ndarje të fondeve.
2. Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, gjatë gjithë procesit të zbatimit të Programit për diplomaci qytetare, do të bashkëpunojë dhe do të koordinohet ngushtë me Zyrën për Qeverisje të Mirë në Kryeministri, për t'u siguruar për mosdiskriminim në ndarjen e fondeve dhe për trajtim të barabartë për të gjitha komunitetet në Republikën e Kosovës.
3. Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, gjatë gjithë procesit të zbatimit të Programit për diplomaci qytetare, do të bashkëpunojë dhe do të koordinohet ngushtë me të gjitha ministrinë e tjera të linjës, varësisht prej nevojave të programit.
4. Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës do të koordinohet me ministrinë e fushave të tjera, për t'i përfshirë profesionistë në veprimtaritë e tyre.

Neni 4

Forma dhe kushtet e aplikimit

1. Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës shpall thirrje publike për subvencionimin e personave fizikë/profesionistë nga diaspora, të cilët do të përfshihen në kuadër të programit për diplomaci qytetare.
2. Thirrja publike shpallet në platformën "online". Të drejtë aplikimi kanë të gjithë personat fizikë, të cilët i plotësojnë kushtet e aplikimit të përcaktuara nga MPJD-ja, në përputhje me këtë program.

3. Personat fizikë e plotësojnë formularin e aplikimit “online” në njërën nga gjuhët zyrtare apo në gjuhën angleze, në afat prej njëzet e pesë (25) ditësh, nga dita e publikimit të thirrjes publike.

Neni 5

Parimet

Gjatë procesit të ndarjes së subvencioneve për personat fizikë duhen respektuar këto parime:

1. liria e pjesëmarrjes;
2. jodiskriminimi dhe trajtimi i barabartë;
3. transparencë e plotë në procedurë dhe në procesin e vendimmarrjes, duke ua ofruar të gjithë kandidatëve të dhënat e njëjta dhe të nevojshme;
4. paanshmëria gjatë procesit të vlerësimit dhe parandalimi i konfliktit të interesit;
5. përjashtimi i mbivendosjes, që nënkupton ndalimin e financimit të të njëjtit shfrytëzues për të njëjtin program më shumë se një (1) herë.
6. parimi i gjithëpërfshirjes gjeografike të profesionistëve nga diaspora.

Neni 6

Kriteret e aplikimit dhe përzgjedhjes

Të gjithë personat fizikë që aplikojnë për përkrahjen financiare në MPJD, në kuadër të këtij programi, duhet t'i plotësojnë kushtet dhe kriteret e mëposhtme:

1. Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës apo pjesëtarë të diasporës/mërgatës, dhe që aktualisht jetojnë jashtë Republikës së Kosovës;
2. Të kenë diplomë universitare;
3. Të kenë së paku dy (2) vjet përvojë profesionale në fushat që ndërlidhen me thirrjen;
4. Të shprehin interesim të qartë për motivimin dhe qëllimin e përfshirjes në këtë program;
5. Të kenë aftësi të larta analitike, vlerësuese dhe raportuese;
6. Të kenë aftësi të larta të vetiniciativës dhe kreativitetit;
7. Përparësi kanë kandidatët që njohin gjuhën angleze, gjermane, frënge, spanjolle, italiane.

Neni 7

Procesi i aplikimit

Procesi i aplikimit është i ndarë në dy faza:

1. Në fazën e parë, kandidatët duhet ta plotësojnë formularin e aplikimit “online”, i cili shqyrtohet nga komisioni vlerësues;
2. Në fazën e dytë, kandidatët e përzgjedhur nga komisioni vlerësues i nënshtrohen një interviste nga distanca (“online”).

Neni 8

Komisioni vlerësues

1. Sekretari i Përgjithshëm i MPJD-së e themelon komisionin vlerësues për shqyrtimin dhe përzgjedhjen e kandidatëve që aplikojnë në thirrjen publike për përkrahje financiare të personave fizikë, në kuadër të Programit për diplomaci qytetare.
2. Komisioni përbëhet nga pesë (5) anëtarë:
 - dy (2) anëtarë nga MPJD-ja;
 - dy (1) anëtar nga bota e akademisë brenda ose jashtë vendit (pjesëtar të diasporës/mërgatës);
 - dy (2) anëtarë nga shoqëria civile brenda ose jashtë vendit (pjesëtar të diasporës/mërgatës);
3. MPJD-ja do ta mbajë pozitën e Kryesuesit të komisionit.
4. Pagesa për anëtarët e komisionit bëhet sipas legjislacionit përkatës për këtë fushë.

Neni 9

Detyrat dhe përgjegjësitë e komisionit vlerësues

1. Komisioni vlerësues ka për detyrë shqyrtimin e të gjitha aplikacioneve që janë dorëzuar brenda afatit në MPJD;
2. Komisioni deri në afatin prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, pas përmbylljes së thirrjes publike, i kryen të gjitha procedurat e shqyrtimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së kandidatëve përfitues në bazë të parimeve dhe kritereve të aplikimit sipas këtij vendimi.
3. Komisioni, për punën e tij, i raporton Sekretarit të Përgjithshëm të MPJD-së.

Neni 10

E drejta për ankesë

1. Kundër vendimit të komisionit vlerësues, të drejtën e ushtrimit të ankesës e kanë të gjithë kandidatët që kanë aplikuar në thirrjen publike.
2. Themelimi, mandati dhe përbërja e komisionit të ankesave përcaktohen me vendim të Sekretarit të Përgjithshëm të MPJD-së.
3. Afati i parashtrimit të ankesave është pesë (5) ditë, pas shpalljes së listës preliminare të kandidatëve të suksesshëm.

Neni 11

Kontrata me përfituesin

1. Në bazë të rekomandimit të komisionit vlerësues, Sekretari i Përgjithshëm i MPJD-së nënshkruan kontratë me përfituesin e subvencionit, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga data e shpalljes së listës përfundimtare.
2. Përmbajtja e kontratës i përcakton kushtet, afatet kohore dhe obligimet e palëve.

3. Kontrata hartohet dhe nënshkruhet në dy (2) kopje identike: nga një (1) për secilën palë.

Neni 12

Mbikëqyrja dhe raportimi

1. Sekretarit i Përgjithshëm i MPJD-së cakton zyrtarin përgjegjës apo ekip për mbikëqyrjen dhe monitorimin e zbatimit të programit.
2. Zyrtari apo ekipi mbikëqyrës, harton raporte periodike dhe përfundimtare lidhur me zbatimin e programit.
3. Secili përfitues, dorëzon raportin narrativ lidhur me angazhimin e tij në kuadër të programit.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 12/154
Datë: 09.08.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 4, 9, 10, 44 dhe nenit 45 të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 9 gusht 2023, merr këtë:

V E N D I M P R E L I M I N A R

1. Miratohet shpronësimi për interes publik i pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit të cilat preken nga realizimi i projektit: renovimi dhe rikonfigurimi i Stadiumit Olimpik "Adem Jashari" në Mitrovicë, sipas tabelave bashkëngjitur këtij Vendimi.
2. Obligohet Departamenti i Shpronësimit që brenda 5 (pesë) ditëve të punës, pas nënshkrimit të këtij Vendimi Preliminar, t'i njoftojë pronarët dhe pretenduesit e tokave të cilat do të shpronësohen dhe brenda afatit prej 10 ditëve të punës pas miratimit të njëjtin ta shpallë në Gazetën Zyrtare të Kosovës.
3. Kundër këtij Vendimi apo cilës do pjesë të tij kanë të drejtë të paraqesin ankesë brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike në Gjykatën Kompetente, subjekti kërkues dhe cili do person i cili është pronar ose zotërues i interesit, në pronën e paluajtshme të prekur nga ky Vendim.
4. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen Departamenti i Shpronësimit (Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës), Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Subjekti Kërkues/ Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS).
5. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë